

Vendim nr. 87 datë 26.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 26.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (B) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **BARDHOK PRENGA,**
MIRASH GJONAJ

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në ngarkim të shtetasve Bardhok Prenga dhe Mirash Gjonaj. Shfuqizimi i vendimeve nr. 3452/28 regjistri themeltar, datë 03.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 507, datë 23.12.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1419, datë 10.11.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se në datën 25.08.2017, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, shtetasja e huaj (bjelloruse) L.Ch. ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasve Bardhok Prenga dhe Mirash Gjonaj (*kërkuesit*), si dhe shtetasit M.B. Materiali kallëzues në këtë rast i është përcjellë për kompetencë ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, e cila ka regjistruar ndaj tyre një procedim penal, për veprën penale “Trafikimi i personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal (*KP*).

2. Gjatë hetimeve paraprake, mbi kërkesën e prokurorit, ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka vendosur sigurimin e provës, dëshmisë së viktimës nga vepra penale L.Ch., dëshmi që është marrë në seancat gjyqësore të datave 8 dhe 9 janar 2018.

3. Në vijim, me vendimin e datës 02.05.2018, ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ia ka kaluar çështjen për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në përfundim të hetimeve paraprake, bazuar në nenin 329/a të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), në datën 18.10.2018, prokurori i shkallës së parë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për pushimin e hetimeve të procedimit penal të regjistruar edhe në emër të kërkuesve, me arsyetimin se nuk provohej që ata të kishin konsumuar elementet e veprës penale “Trafikimi i personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në seancë paraprake, me vendimin nr. 4722 regjistri themeltar, datë 27.12.2018, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve sipas përcaktimeve në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, duke caktuar një afat 60-ditor për përfundimin e tyre.

5. Në vijim të hetimeve paraprake, në datën 04.07.2019, prokurori i shkallës së parë ka paraqitur sërish pranë gjyqtarit të seancës paraprake një kërkesë për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. 3651, datë 09.05.2018, për veprën penale “Trafikimi i personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së, me të njëjtin arsyetim si më parë, pra që nuk provohej se personat nën hetim, ndër ata edhe kërkuesit, të kishin konsumuar elementet e veprës penale të sipërcituar.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në seancë paraprake, bazuar në nenet 329, pika 3, shkronja “c” dhe 329/b, pika 3, të KPP-së, me vendimin nr. 3452/28 regjistri themeltar, datë 03.07.2020, ka vendosur: *“Kthimin e akteve të hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 3651, të vitit 2018, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë të formulojë akuzë ndaj personave të hetuar M.B., Mirash Gjonaj e Bardhok Prenga, për veprën penale për të cilën janë hetuar “Trafikimi i personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a/4 të K.Penal dhe të paraqesë përpara gjykatës, kërkesë për gjykimin e çështjes penale...”*. Gjyqtari i seancës paraprake ka arsyetuar se nuk plotësohej asnjë nga kushtet e parashikuara në nenin 328 të KPP-së për pushimin e hetimeve të procedimit penal, sikundër prokurori kërkonte. Nga ana tjetër, gjyqtari i seancës paraprake ka vlerësuar se ndaj personave të hetuar ka patur prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjykim. Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur se kundër tij lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

7. Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, bazuar në nenet 329, pika 6 dhe 329/b, pika 6, të KPP-së, ka ushtruar ankim prokurori i shkallës së parë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake dhe miratimin e kërkesës për pushimin e hetimeve të procedimit penal.

8. Gjykata e Apelit Tiranë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 507, datë 23.12.2020, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 3452/28 akti, datë 03.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*, duke i gjetur të drejta, të bazuara në prova dhe ligj përfundimet e gjyqtarit të seancës paraprake. Kundër këtij vendimi, në datën 04.02.2021, kërkuar kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1419, datë 10.11.2022, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personat nën hetim Mirash Gjonaj dhe Bardhok Prenga, kundër vendimit nr. 507, datë 23.12.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë”*, me arsyetimin se në bazë të neneve 329, pikat 3, shkronja “c” dhe 6, 329/b, pika 6, dhe 407, pika 1, të KPP-së, si dhe parimit *lex specialis derogate legi generali*, kërkuar nuk legjitimohen të paraqesin ankim/rekurs kundër vendimmarrjes së gjykatës, e cila ka disponuar për kthimin e akteve prokurorit, duke urdhëruar që të formulojë akuzë ndaj personave të hetuar dhe të paraqesë përpara gjykatës kërkesën për gjykimin e çështjes penale. Kjo, pasi ankimi nga ky subjekt i procesit penal nuk është i parashikuar në dispozitat e posaçme të ligjit procedural penal.

10. Në datën 09.03.2023 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe shfuqizimin e vendimeve nr. 3452/28 regjistri themeltar, datë 03.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 507, datë 23.12.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2022-1419, datë 10.11.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesve

11. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

11.1. *E drejta për t'u njoftuar*, pasi në gjykimin e çështjes në shkallë të parë mbrojtësi ligjor i kërkuesve nuk është njoftuar me fletëthirrje për seancën gjyqësore të datës 26.06.2020, për rrjedhojë kjo seancë është zhvilluar pa praninë e tij. Në fletëthirrjen nr. 28 akti, datë 22.05.2020, nëpunësi gjyqësor ka shënuar se avokatit i mungon adresa e banimit dhe e zyrës, si dhe në Dhomën e Avokatisë nuk ka adresë për të, ndërkohë që ai ka marrë pjesë në seanca të tjera gjyqësore të zhvilluara në kuadër të çështjes në këtë gjykatë.

11.2. *E drejta e mbrojtjes*, pasi në gjykimin e çështjes në shkallë të parë kërkuesit janë vënë në pozita inferiore, në kushtet e mungesës së mbrojtjes efektive në seancën gjyqësore të datës 26.06.2020, të zhvilluar pa pasur dijeni ata dhe mbrojtësi i tyre. Në mungesë të mbrojtësit ligjor kërkuesit nuk kanë mundur të paraqesin kërkesa, prova, fakte ose argumente dhe në dëm të tyre është dhënë një vendim gjyqësor, pa një proces të rregullt gjyqësor.

11.3. *Parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykim*, pasi mungesa e mbrojtësit të tyre ligjor në gjykimin e çështjes në shkallë të parë i ka vënë kërkuesit në disavantazh, ndërsa për ata nuk ka qenë e mundur që në seancë gjyqësore të zhvillonin një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes. Në gjykimin penal duhet që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëlloj si ato të prokurorit.

11.4. *E drejta e ankimit*, pasi kërkuesve dhe mbrojtësit të tyre nuk u është komunikuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ata kanë marrë dijeni me vonesë vetëm mbi ankimin e organit të akuzës. Në datën 19.12.2020, pesë ditë përpara zhvillimit të

seancës gjyqësore në gjykatën e apelit, mbrojtësi i kërkuësve ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke evidentuar shkeljet ligjore për një proces të rregullt ligjor në gjykimin e çështjes në shkallë të parë. Këto parashtrime nuk përmenden në vendimin e gjykatës së apelit dhe nuk gjenden as në dosjen gjyqësore. Gjykata e apelit duhet të prishte vendimin e gjykatës së shkallës së parë për shkeljet e rënda të lejuara gjatë procesit gjyqësor.

- 11.5. *E drejta e aksesit në gjykatë*, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke mos pranuar rekursin e kërkuësve, ka krijuar një precedent shumë të rrezikshëm, ndërkohë që kjo gjykatë ka shkelur edhe parimin e hierarkisë së ligjeve.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

13. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkuësi, si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Shterimi i mjeteve juridike përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet ligjore shterojnë, kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimin nr. 77, datë 19.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtijshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Megjithatë, në jurisprudencën e saj në fushën penale, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore jo përfundimtare në kuptim të legjislacionit procedural penal, siç janë ato për caktimin ose zëvendësimin e masave të sigurimit personal, ose ato për konfiskimin e pasurisë gjatë procedimit penal, për shkak të natyrës së këtyre vendimeve dhe pasojave që sjellin në të drejtat themelore të individit (*shih vendimet nr. 48, datë 06.07.2015; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese; nr. 135, datë 02.12.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

18. Duke iu kthyer çështjes në gjykim, Kolegji vëren se kërkuesit përmes kërkesës në shqyrtim, kanë kundërshtuar vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake që nuk ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e hetimeve të procedimit penal ndaj tyre, por ka vendosur kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë për ata akuzë dhe të paraqesë kërkesë për

gjykimin e çështjes penale. Po kështu, kërkuesit kanë kundërshtuar edhe vendimin e gjykatës së apelit që ka lënë në fuqi vendimin e gjyqtarit të seancës paraprahe, e cila është vënë në lëvizje me ankimin e prokurorit. Gjithashtu, kërkuesit kanë kundërshtuar edhe vendimin e Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre, për shkak se ata sipas ligjit procedural penal nuk legjitimohen të bëjnë ankim ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprahe që ka disponuar në mënyrën si më lart.

19. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se, në thelb, kërkuesit kundërshtojnë procesin dhe vendimin gjyqësor, përmes të cilit aktet e procedimit penal i kanë kaluar prokurorit me detyrimin për të formuluar akuzë ndaj tyre dhe paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes penale. Zbatimi i këtij vendimi nga prokurori passjell në vijim shqyrtimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq nga gjyqtari i seancës paraprahe, i cili, bazuar në nenin 332/dh të KPP-së, në mënyrë alternative mund të vendosë për dërgimin e çështjes në gjyq, duke i hapur kështu rrugë gjykimit në themel të çështjes penale kundër kërkuesve ose për pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1 të nenit 328 të KPP-së. Sipas ligjit procedural penal (neni 332/dh, pika 3, të KPP-së), procedura e shqyrtimit në seancë paraprahe nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj.

20. Në vështrim të kësaj analize, Kolegji çmon se vendimet gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesit nuk janë vendime përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi ato jo vetëm që nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për fajësinë ose jo të kërkuesve për veprën penale që dyshohet të kenë kryer, por as nuk provohet që këto vendime të kenë ndonjë efekt të tillë cënues në të drejtat themelore të kërkuesve, të cilat nuk mund të mbrohen gjatë vijimit të procesit penal.

21. Kolegji thekson se në kushtet kur kriteri paraparak për shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.